

Vendim nr. 95 datë 03.05.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 03.05.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (D) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **DELIN HAJDARAJ**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 376, datë 02.07.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 381, datë 09.06.2016 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2022-1812 (273), datë 27.10.2022 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pikat 1 dhe 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në datën 28.07.2013 ka regjistruar procedimin penal nr. 430 të vitit 2013 ndaj kërkuarit Delin Hajdaraj, duke e akuzuar

për veprat penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të kryer ndaj 8 personave në bashkëpunim, nga të cilat 3 vepra penale të realizuara dhe 5 në tentativë, të parashikuar nga neni 79, shkronja “dh” e 25 të Kodit Penal (KP), si dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje të armëve dhe municioneve luftarake” me pasoja të rënda, të parashikuar nga neni 278/5 i KP.

2. Me kërkesë të prokurorit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 284, datë 31.07.2013, ka caktuar masën e sigurimit “Arrest në burg” ndaj kërkuesit. Mbi bazën e këtij vendimi në datën 23.08.2013 është urdhëruar kërkimi ndërkombëtar i tij.

3. Pas përfundimit të hetimeve paraprake, prokurori e ka dërguar çështjen në gjyq. Gjykimi është zhvilluar në mungesë të kërkuesit, dhe gjykata e shkallës së parë i ka caktuar mbrojtës kryesisht. Në vijim, në gjykim është paraqitur dhe ka marrë pjesë mbrojtësi i zgjedhur prej vetë kërkuesit me anë të prokurës së posaçme të datës 22.09.2014. Mbrojtësi i zgjedhur ka kërkuar shqyrtimin e çështjes nga e para, me qëllim paraqitjen e kërkesës për gjykim të shkurtuar të çështjes. Ai ka pretenduar se njoftimi i kërkuesit ka qenë i pavlefshëm, por kjo kërkesë është refuzuar nga gjykata. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 376, datë 02.07.2015, ka vendosur deklarinimin fajtor të tij sipas akuzave të ngritura dhe dënimin me burgim të përjetshëm.

4. Kundër vendimit ka ushtruar ankim mbrojtësi i kërkuesit, duke kërkuar prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim me pretendimin se procesi gjyqësor ishte i parregullt për shkak të mosrespektimit të rregullave të njoftimit të të pandehurit. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 381, datë 09.06.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar se pretendimi për njoftimin e kërkuesit ishte i pabazuar. Sipas saj, gjykata e shkallës së parë ka respektuar dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me njoftimin. Në nxjerrjen e këtij përfundimi, gjykata ka vlerësuar edhe faktin se kërkuesi kishte lëshuar prokurë të posaçme, me të cilën i kishte dhënë tagra mbrojtësit për ta përfaqësuar në mungesë të tij.

5. Mbrojtësi i kërkuesit ka paraqitur rekurs, duke kërkuar prishjen e vendimeve të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe të gjykatës së shkallës së parë, si dhe kthimin e çështjes për rigjykim. Ai ka pretenduar se procesi gjyqësor ka qenë i parregullt për shkak të mosrespektimit të së drejtës së njoftimit. Sipas tij, për shkak të kësaj shkeljeje, kërkuesit i janë mohuar garancitë e mbrojtjes dhe mundësia e paraqitjes së kërkesës për gjykim të shkurtuar të çështjes.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin 00-2022-1812 (273), datë 27.10.2022, ka vendosur: (i) lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë lidhur me fajësinë, cilësimin juridik dhe dënimin për veprën penale të vrasjes me dashje në rrethana cilësuese; (ii) ndryshimin e vendimit për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, duke e ulur dënimin në gjashtë vjet burgim për shkak të zbatimit të ligjit penal më favorizues;

(iii) dënimin përfundimtar me burgim të përjetshëm, si rezultat i bashkimit të dënimeve për veprat penale.

7. Në datën 28.02.2023 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë.

II

Pretendimet e kërkuetit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi nuk është njoftuar rregullisht për zhvillimin e gjykimit në shkallë të parë, shkelje e cila nuk është riparuar nga gjykatat më të larta.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Në çështjen konkrete, Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, në të cilin është vendosur dënimi i tij me burgim të përjetshëm, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve ligjore efektive*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë

përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individi duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 17, datë 16.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin në shqyrtim, kërkuesi ka kundërshtuar vendimet gjyqësore, përfshi atë të Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor, në të cilin ai është deklaruar fajtor penalisht dhe është dënuar me burgim të përjetshëm. Ai pretendon se nuk është njoftuar rregullisht për gjykimin në shkallë të parë dhe ndonëse e ka paraqitur këtë pretendim edhe në gjykatat më të larta, kjo shkelje nuk është riparuar. Për pasojë, Kolegji vlerëson se kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion është përmbushur, pasi kërkuesi nuk ka më mjete të tjera ankimi.

13. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Kolegji vëren se vendimi më i fundit që ka përmbyllur procesin e kundërshtuar nga kërkuesi është ai i Gjykatës së Lartë, i cili mban datën 27.10.2022, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 28.02.2023. Për rrjedhojë, kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4 - mujor.

14. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuesi pretendon se gjykatat i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, pasi ai nuk është njoftuar sipas ligjit për fillimin e procesit gjyqësor, ndaj nuk ka pasur mundësi të mbrohej. Njoftimi i të pandehurit, si garanci për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, duhet të bëhet përpara fillimit të procesit gjyqësor dhe jo në mes të tij. Njoftimi me shpallje nga gjykata ka vetëm datën e marrjes nga rajoni, mungon procesverbali për datën e shpalljes, shpallja nuk është vendosur në banesën e tij, ndërsa shkresa e policisë për njoftimin e të pandehurit ka sqaruar vendqëndrimin e tij në Lazarat. Sipas kërkuesit, ai ka zgjedhur mbrojtës me prokurë të posaçme sapo është vënë në dijeni të procesit që po zhvillohej kundër tij.

15. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se liria nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor (*pika 1*) dhe se kushdo, në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj (*pika 2*). Në veçanti për procesin penal, neni 31 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo ka të drejtë të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, t'i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij (*shkronja “a”*), të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtje falas kur nuk ka mjete të mjaftueshme (*shkronja “ç”*). Ndërsa në nenin 33 të Kushtetutës përcaktohet se kushdo ka të

drejtë të dëgjohej (*pika 1*), por nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë (*pika 2*).

16. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të janë të lidhura me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit (*shih vendimin nr. 20, datë 22.09.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta e mbrojtjes në procesin penal, si një nga elementet thelbësore për një proces të drejtë, përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte. Shteti ka detyrimin për ta njoftuar të pandehurin në mënyrë efektive dhe të përshtatshme për seancën, si dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij (*shih vendimin nr. 14, datë 21.06.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin e gjykimit në mungesë është detyrë e autoriteteve publike që të informojnë të pandehurin nëse ka ose jo një procedim penal në ngarkim të tij, pasi vetëm kështu mund të arrihet siguria se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim (*shih vendimet nr. 40, datë 06.07.2016; nr. 30, datë 17.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërsa personat që i fshihen drejtësisë humbasin të drejtën për t'u dëgjuar nga gjykata. Në këtë kuptim, Kushtetuta ka ligjëruar gjykimin e të pandehurit në mungesë në rastet kur ai ka marrë dijeni se ndaj tij ka filluar një proces penal dhe kur ka hequr dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në të (*shih vendimet nr. 84, datë 26.12.2017; nr. 30, datë 17.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Kolegji vëren se kërkuesi është njoftuar rregullisht për zhvillimin e procesit penal ndaj tij dhe ka zgjedhur me vullnet të lirë t'i fshihet drejtësisë. Masa e sigurimit “*Arresti në burg*”, e caktuar ndaj tij, ka mbetur e pazbatuar, ndaj në datën 23.08.2013 është urdhëruar edhe kërkimi ndërkombëtar i tij. Gjykata e shkallës së parë ka kryer procedurat e njoftimit sipas ligjit, ka konstatuar se kërkuesi ishte person në kërkim policor dhe ka urdhëruar edhe njoftimin e tij përmes afishimit të kopjes së shpalljes në rajonin ku ai banonte, përfshirë edhe portën e banesës së tij. Në vijim, gjykata e shkallës së parë ka vendosur gjykimin në mungesë të kërkuesit, duke i caktuar kryesisht atij një avokat. Më tej, gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar me pjesëmarrjen e mbrojtësit të zgjedhur prej vetë kërkuesit. Mbrojtësi ka ushtruar efektivisht të drejtat në proces, duke përfshirë debatin mbi provat, paraqitjen e kërkesave dhe argumenteve, si dhe ankimin në gjykatat më të larta. Kolegji konstaton se humbja e së drejtës për të kërkuar gjykimin e shkurtuar nuk është pasojë e mosrespektimit të procedurave të njoftimit, por ka ardhur si rezultat i paraqitjes në gjykim të mbrojtësit të zgjedhur pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes në shkallë të parë.

18. Po ashtu, Kolegji vëren se mbrojtësi ka ushtruar rregullisht edhe të drejtën e ankimit në substancë. Pretendimi i paraqitur prej tij për parregullsitë e njoftimit të kërkuesit në shkallë

të parë, është analizuar dhe ka marrë përgjigje nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe Gjykata e Lartë. Këto gjykata kanë vlerësuar se pretendimi është i pabazuar në ligj dhe në prova, pasi gjykata e shkallës së parë ka respektuar dispozitat ligjore të njoftimit (*shih faqen 18 të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë*), e cila ka zhvilluar disa seanca gjyqësore derisa ka siguruar shterimin e procedurës së njoftimit të kërkuarit dhe caktimin e një avokati kryesisht për të (*shih paragrafët 23-24 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

19. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor është haptazi i pabazuar, ndaj çështja nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.